




REPUBLIKA E KOSOVES		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-460/16
Dep.		Prot. No.	
Nr. Titull		Data	05-02-2016
Broj. shënime	02	Datum	
Nr. pages		Data	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.02.2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-4238/15, për z. Vladimir Jaksic – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Mitrovicës veriore, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-4238/15, për z. Vladimir Jaksic – Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Mitrovicës veriore, dhe njëkohësisht pronar aktiv në biznesin privat “Elite”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e AKK-së.

z. Jaksic është njoftuar se nuk mund të ushtroj funksionin e pronarit aktiv në biznes privat, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë, ndërsa ai ka premtuar që në afat sa më të shpejt do të shmang konfliktin e interesit duke autorizuar një person të besuar për të menaxhuar këtë biznes.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se z. Jaksic ka caktuar një person të besuar për të

menaxhues biznesin e tij dhe tani ai është pronar pasiv i këtij biznesi. Me këtë ai ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.


Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

U skladu sa članom 11.(stav1.1), članom 5(stav 1, tačka 1.5), članom 18 (stav 10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, kao i sa članom 24 (stav 11 i 12) Pravilnika o Radu Agencije protiv Korupcije,br.01/2014, Direktor Agencije protiv Korupcije , dana 03.02.2016 doneo je sledeću

ODLUKU

I. Zatvara se slučaj broj AKK-03-02-4238-15 za g.Vladimira Jakšića- Direktor za Zdravstvo I Socijalno Osiguranje u Opštini Severne Mitrovice, zato što je on izbegao situaciju sukoba interesa u u kojoj je bio.

II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se pojavljuju nove okolnosti.

O b r a z l o ž e n j e

I. Pokrenuti slučaj pod osnovanom sumnjom za Sukob Interesa u Vršnju Javne Funkcije, br. **AKK-03-02-4238-15 -za g.Vladimira Jakšića- Direktora za Zdravstvo i Socijalno Osiguranje u Opštini Severne Mitrovice**, i istovremeno aktivni vlasnik u privatnom biznisu"ELITE", je tretiran prema predviđenoj proceduri po Zakonu br.04/L-051 za sprečavanje sukoba interesa u toku vršenja javne funkcije.

g.Jakšiću je prvo upućeno službeno pismo sa obaveštenjem o pokretanju procedure razmatranja mogućeg stanja sukoba interesa , nakon čega je on kontaktirao službenike APK.

g.Jakšić je upoznat sa time da ne može vršiti funkciju aktivnog vlasnika u privatnom biznisu uporedo sa funkcijom visokog javnog zvaničnika , dok je on obećao da će u najkraćem roku otkloniti sukob interesa ,time što će ovlastiti poverljivo lice za menadžiranje sa ovim biznisom.

U međuvremenu, isti je Agenciji protiv Korupcije dostavio službeno pismo od strane Agencije za Registraciju Biznisa na Kosovu kojim se potvrđuje da je g.Jakšić odredio poverljivo lice za menadžiranje njegovim biznisom, i sada je on pasivni vlasnik ovog biznisa. Ovime je izbegnuta situacija sukoba interesa na kojoj se nalazio .

Stoga je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja .

II. Uskladu sa članom 18(stav11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može u svako doba obnoviti slučaj kada se pojavljuju nove okolnosti, pa je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja .

Odluka se dostavlja:

- visokom javnom zvaničniku
- direktoru DSK
- odgovornom službeniku

Direktor Agencije protiv Korupcije:

Hasan Preteni

